447. Arkivi i Autoritetit, Fondi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë, kutia nr. 3, dosja nr. 93. Informacione të Drejtorisë së III-të të MPB, drejtuar KQ të PPSH, lidhur me situatën e rëndë politike në Jugosllavi, konfliktet Serbi-Sllloveni-Kroaci-Kosovë, si dhe qëndrimi i Shqipërisë dhe i ndërkombëtarëve ndaj kësaj situatë. Dosja daton në vitin 1989, me 32 (tridhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
448. Arkivi i Autoritetit, Fondi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë, kutia nr. 3, dosja nr. 94. Informacion i Drejtorisë së III-të të MPB, drejtuar KQ të PPSH, lidhur me aksionin e serbëve për mbledhjen e armëve në Kosovë. Dosja daton në vitin 1989, me 2 (dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
449. Arkivi i Autoritetit, Fondi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë, kutia nr. 3, dosja nr. 95. Studim i Drejtorisë së III-të të MPB, drejtuar KQ të PPSH, mbi ndryshimet aktuale kushtetuese në Jugosllavi në vitin 1989. Dosja daton në vitin 1989, me 79 (shtatëdhjetë e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
450. Arkivi i Autoritetit, Fondi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë, kutia nr.2, dosja nr.22, Informacione të Drejtorisë së III-të të MPB, drejtuar Komitetit Qendror të P.P.SH-së, mbi disa probleme në regjistrin e radiozbulimit. Dosja daton në vitin 1982, me 2 (dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
451. Arkivi i Autoritetit, Fondi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë, kutia nr.2, dosja nr.23, Informacione të Drejtorisë së I-rë të MPB, drejtuar Komitetit Qendror të P.P.SH-së, lidhur me specialistët hungarez që kanë ardhur e do të vijnë për rikonstrukcionin e uzinës së Antibiotikut. Dosja daton në vitin 1982, me 2 (dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
452. Arkivi i Autoritetit, Fondi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë, kutia nr.2, dosja nr.24, Informacione të Drejtorisë së I-rë të MPB, drejtuar Komitetit Qendror të P.P.SH-së, lidhur me komentet armiqësore rreth Pleniumeve të 4-t e të 5-të të K.Q të Partisë dhe arrestimin e armikut K. H. Dosja daton në vitin 1982, me 5 (pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
453. Arkivi i Autoritetit, Fondi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë, kutia nr.2, dosja nr.25, Informacione

- one të Drejtorisë së III-të, drejtuar Komitetit Qendror të P.P.SH-së, mbi veprimtarinë propagandiste të "Legalitetit" kunder vendit tonë, si dhe mbi organizatën "Bashkimi Nacionalistëve Shqipëtar". Dosja daton në vitin 1982, me 10 (dhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
454. Arkivi i Autoritetit, Fondi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë, kutia nr.2, dosja nr.26, Informacione të Drejtorisë së I-rë të MPB, drejtuar Komitetit Qendror të PPSH-së, mbi marrëdhëniet turko-shqiptare dhe qëndrimet ndaj dy superfuqive. Dosja daton në vitin 1982, me 3 (tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
455. Arkivi i Autoritetit, Fondi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë, kutia nr.2, dosja nr.27, Informacione të Drejtorisë së I-rë të MPB të MPB, drejtuar Komitetit Qendror të P.P.SH-së, mbi disa probleme që kanë dalë gjatë 6-mujorit të parë të 1982 në disa drejtime e objekte të ekonomisë socialiste. Dosja daton në vitin 1982, me 8 (tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
456. Arkivi i Autoritetit, Fondi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë, kutia nr.2, dosja nr.28, Informacione të Drejtorisë së I-rë të MPB, drejtuar Komitetit Qendror të P.P.SH-së, në lidhje me shkrime të ndryshme për vendin tonë, nga buletine, revista, ushtarake-politike, si dhe shtypi i huaj. Dosja daton në vitin 1982, me 35 (tridhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
457. Arkivi i Autoritetit, Fondi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë, kutia nr.2, dosja nr.29, Informacione të Drejtorisë së I-rë të MPB, drejtuar Komitetit Qendror të P.P.SH-së, për disa letra të ardhura, me përmbajtje armiqësore ose jo. Dosja daton në vitin 1982, me 18 (tetëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
458. Arkivi i Autoritetit, Fondi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë, kutia nr.2, dosja nr.30, Informacione të Drejtorisë së I-rë të MPB, drejtuar sekretarit të parë Komitetit Qendror të P.P.SH-së, mbi disa reagime dhe komente të diplomatëve të huaj që morën pjesë në manifestimet e Majit. Dosja daton në vitin 1982, me 6 (gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
459. Arkivi i Autoritetit, Fondi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë, kutia nr.2, dosja nr.31, Relacione të Komitetit të Partisë së Rrethit Fier, drejtuar sekretarit të Komitetit Qendror të PPSH-së, lidhur mbi një informacion nga shoku H. K. Dosja daton në vitin 1982, me 5 (pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
460. Arkivi i Autoritetit, Fondi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë, kutia nr.2, dosja nr.32, Informacione të Drejtorisë së I-rë të MPB, drejtuar sekretarit të Komitetit Qendror të P.P.SH-së, mbi përgatitjet e grupeve diversioniste nga radhët e të arratisurve jashtë shtetit. Dosja daton në vitin 1982, me 2 (dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
461. Arkivi i Autoritetit, Fondi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë, kutia nr.2, dosja nr.33, Informacion i Drejtorisë së III-të, drejtuar Komitetit Qendror të P.P.SH-së, mbi gjendjen dhe udhëheqjen në Bullgari. Dosja daton në vitin 1982, me 5 (pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
462. Arkivi i Autoritetit, Fondi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë, kutia nr.2, dosja nr.34, Informacione të Drejtorisë së I-rë të MPB, drejtuar sekretarit të Komitetit Qendror të P.P.SH-së, mbi prodhimin e disa armëve, në kundërshtim me ligjet në repartin 7306 në Tiranë. Dosja daton në vitin 1982, me 5 (pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
463. Arkivi i Autoritetit, Fondi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë, kutia nr.2, dosja nr.35, Informacione të Drejtorisë së I-rë të MPB, drejtuar sekretarit të parë Komitetit Qendror të PPSH-së, mbi deponimet e S. K. Dosja daton në vitin 1982, me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
464. Arkivi i Autoritetit, Fondi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë, kutia nr.2, dosja nr.36, Informacion i Ministrisë së Punëve të Brendshme mbi mbledhjen e komisionit të përbashkët Shqiptaro-Jugosllav. Dosja daton në vitin 1982, me 8 (tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
465. Arkivi i Autoritetit, Fondi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë, kutia nr.2, dosja nr.37, Informacione të Drejtorisë së III-të, mbi krizën ekonomike në Jugosllavi dhe gjendjen kritike të popullit atje. Dosja daton në vitin 1982, me 2 (dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
466. Arkivi i Autoritetit, Fondi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë, kutia nr.2, dosja nr.38, Informacione të Drejtorisë së I-rë të MPB, drejtuar sekretarit të Komitetit Qendror të PPSH-së, mbi grupet turistike "Studimore", si dhe turneun e ekipit të shahut në Zvicër. Dosja daton në vitin 1982, me 9 (nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
467. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 2. Dosje me implikimet në komplotin e M. Sh., e K. H., me 453 (katërqind e pesëdhjetë e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1982-1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
468. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 2. Lidhje të komplotistëve, M.Sh., e K.H., me 177 (njëqind e shtatëdhjetë e shtatë) fletë. Dosja daton në vitet 1979-1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
469. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 3 dhe 4. Dosje operative pa nr. për F. Sh., me 24 volume, në total me 5018 (pesëmijë e tetëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1975-1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
470. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 4. Dosje agjenturore "Merimanga" me 14 volume ne total me 3912 (tremijë e nëntëqind e dymbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1975-1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
471. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 4. Dosje me indekse për implikimet për F. Sh., me 228 (dyqind e njëzet e tetë) fletë. Dosja daton në 1982. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
472. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 4. Dosje agjenturore "Mercenari" me 168 (njëqind e gjashtëdhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1985-1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
473. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 6. Dosje me indekse, me materiale për K. H., me 115 (njëqind e pesëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
474. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 6. Dosje me implikimet të ndyshme për grupet anti-parti, me 364 (treqind

- e gjashtëdhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1982-19910. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
475. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 6. Fashikull i indekstit alfabetik për dosjen e të arratisurit, S. P., me 230 (dyqind e tridhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
  476. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 6. Dosje me implikime për M. B., me 103 (njëqind e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1974-1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
  477. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 6. Dosje me indekse të përonave të implikuuar ne dosjet e grupeve antiparti, me 40 (dyzet) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
  478. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 6. Fashikull për I. S., me 105 (njëqind e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1982-1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
  479. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 6. Fashikull për Q. M., me 50 (pesëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1982-1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
  480. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 7. Dosje për M. Z., me 7 volume ne total 1388 (njëmijë e treqind tetëdhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1974-1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
  481. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 7. Fashikull alfabetik për "Armikun" M. Z., me 211 (dyqind e njëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1974-1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
  482. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 7. Dosje nr.890 për S. B., me 2 volume në total 549 (pesëqind e dyzet e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1974-1982. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
  483. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 7. Fashikull nr.192 në ngarkim të S. B., me 97 (nëntëdhjetë e shtatë) fletë. Dosja daton në vitin 1982. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
  484. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 7. Dosje me kopje të procesverbalëve nr.4 për S. B., me 33 (tridhjetë e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1975-1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
  485. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 7. Dosje hetimore nr.44 për S. B., me 273 (dyqind shtëdhjetë e tre) fletë. Dosja daton në vitin 1982. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
  486. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 7. Fashikull për K. N., me 48 (dyzet e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1982-1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
  487. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 7. Fashikull për H. K., me 46 (dyzet e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1975-1984. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
  488. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 7. Materiale për antarë partie dhe kandidatëve të partisë, me 303 (treqind e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1973-1981. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
  489. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 8. Fashikull me lista, vendime, analiza, relacione të veprimtarisë armiqësore, me 11 volume, në total me 3777 (tremijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë) fletë. Dosja daton në vitet 1957-1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
  490. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 8. Dosje operative nr.1 për E. Gj., me 260 (dyqind e gjashtëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1957-1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
  491. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 9. Dosje formulare nr.1773 për M. P., me 526 (pesëqind e njëzet e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1974-1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
  492. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 9. Dosje hetimore nr.192 për M. P., me 329 (treqind e njëzet e nëntë) fletë. Dosja daton në vitin 1982. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
  493. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 9. Fashikull nr.45 për M. P., me 194 (njëqind e nëntëdhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1974-1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
  494. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 9. Fashikull nr.3 për M. P., me 45 (dyzet e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1974-1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
  495. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 9. Dosje operative për Ll. P., me 3 volume në total me 671 (gjashtëqind e shtatëdhjetë e një) fletë. Dosja daton në vitet 1974-1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
  496. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 9. Dosari alfabetik i materialeve të armiqëve për Ll. P., K. M., Z. Th., me 2 volume totali 364 (treqind e gjashtëdhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1974-1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
  497. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 9. Dosje operative nr.1 për Ll. Z., me 230 (dyqind e tridhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1974-1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
  498. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 9. Dosje hetimore me dy vëllime, dosje formulare me dy vëllime dhe fashikull në ngarkim të H. R., në total me 505 (pesëqind e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1974-1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
  499. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 9. Dosje operative për L. P., me dy vëllime, në total me 515 (pesëqind e pesëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1974-1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
  500. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 10. Fashikull nr.1 për Z. Th., me 261 (dyqind e gjashtëdhjetë e një) fletë. Dosja daton në vitet 1977-1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
  501. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 10. Fashikull nr.2 për Z. Th., me 239 (dyqind e tridhjetë e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1953-1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
  502. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 10. Dosje formulare nr.35799 për N. N., me 305 (treqind e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1977-1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
  503. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 10. Dosje operative nr.1 për K. H., me 260 (dyqind e gjashtëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1973-1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
  504. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 10. Dosje operative nr.2 për K. H., me 248 (dyqind e dyzet e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1973-1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
  505. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 10. Dosje operative nr.1 për Xh. P., me 225 (dyqind e njëzet e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1974-1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
  506. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 10. Dosje operative nr.1 për J. X., me 130 (njëqind e tridhjetë) fletë. Dosja

- daton në vitet 1944-1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
507. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 10. Dosje formulare nr. 35634, "Pinca" në ngarkim të A. C., me 2 volume total me 160 (njëqind e gjashtëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1973-1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
  508. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 10. Dosje formulare nr.4227 për D. Sh., me 3 volume në total me 160 (njëqind e gjashtëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1981-1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
  509. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 10. Dosje operative për A. H., me 2 volume në total me 184 (njëqind e tetëdhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1975-1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
  510. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 10. Dosje operative për H. H., me 103 (njëqind e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1982-1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
  511. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 11. Dosje formulare nr.3210 për R. P., me 468 (katërqind e gjashtëdhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1974-1982. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
  512. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 11. Dosje formulare nr.3210/1 për R. P., me 225 (dyqind e njëzet e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1983-1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
  513. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 11. Dosje nr.128 Informimi MMP mbi grupin kongolez me 20 (njëzet) fletë. Dosja daton në vitin 1966. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
  514. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 11. Dosje nr.3 Relacione të komandës ushtarake "Repartitit 1200" me 4 (katër) fletë. Dosja daton në vitin 1967. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
  515. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 11. Dosje nr.7 vendime, relacione mbi kurset luftarake dhe politike që zhvillojnë të huajt në Shqipëri me 27 (njëzet e shtatë) fletë. Dosja daton në vitin 1967. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
  516. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 11. Dosje nr.2 vendime, relacione të komandës ushtarake dërguar Ministrisë së Mbrojtjes Popullore me 5 (pesë) fletë. Dosja daton në vitin 1968. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
  517. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 11. Dosje nr.6 vendime, relacione të komandës ushtarake të "Repartiti 8001" me 2 (dy) fletë. Dosja daton në vitin 1968. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
  518. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 11, dosje nr.7 vendim i Sekretarit KOPPSH nr.543 me datë 02.08.1968 mbi aprovimin e kërkesës të PK për të dërguar gjashtë kursantë në Shqipëri me 5 (pesë) fletë. Dosja daton në vitin 1968. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
  519. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 11. Dosje nr.105 Relacione mbi përgatitjen politiko luftarake të togës speciale Indoneziane politike, me 8 (tetë) fletë. Dosja daton në vitin 1968. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
  520. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 11. Dosje nr.115 Relacione drejtuar MMP mbi grupet e huaja që kanë qënë në Shqipëri me 13 (trembëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1968. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
  521. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 11. Dosje nr.137 Relacione mbi zhvillimin e stërvitjes ushtarake të grupit të të huajëve pranë "Repartit ushtarak 5999", me 5 (pesë) fletë. Dosja daton në vitin 1968. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
  522. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 11. Dosje nr.137 Informacion i komandës të "Repartiti 5999", kërkesë dërguar MMP me 8 (tetë) fletë. Dosja daton në vitin 1969. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
  523. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 11. Dosje nr.138 Informacion i komandës të "Repartiti 3711", kërkesë dërguar MMP me 5 (pesë) fletë. Dosja daton në vitin 1969. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
  524. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 11. Dosje nr.139 Relacione dhe lista e anëtarëve të partisë Ekuadorit me 2 (dy) fletë. Dosja daton në vitin 1969. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
  525. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 11. Dosje nr.113 Informacione mbi disa çështje me shokët e delegacioneve të organizuar për çlirimin e Palestinës me 31 (tridhjetë e një) fletë. Dosja daton në vitin 1970. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
  526. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 11. Dosje nr.166 Informacion i sektorit të MMP drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme, me 10 (dhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1971. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
  527. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 11. Dosje Fondi i Solidaritetit mbi dhënien e ndihmave financiare disa partive dhe grupeve marksiste-leniniste, me 257 (dyqind e pesëdhjetë e shtatë) fletë. Dosja daton në vitet 1964-1977. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
  528. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, arka 11. Dosje nr.23 mbi trajtimin ekonomik të miqve të huaj me 8 (tetë) fletë. Dosja daton në vitin 1968. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".

**KRYETARI I KDZH**  
**Dr. Gentiana Sula**



## KUJTESA DHE EDUKIMI QYTETAR



## FESTIVALI NDËRKOMBËTAR PËR TË DREJTAT E NJERIUT VJEN NË AIDSSH

Tiranë më 19 shtator 2024



- Ekspertë të drejtave të njeriut, ish-të përndjekur politikë, specialistë të AIDSSH-së, ekspertë të proceseve të rikuperimit të trupave të zhdukurve ndoqën dhe diskutuan rreth problematikave mbi të cilat janë ndërtuar dy dokumentarët “Plumbi i Tretë” dhe “ADN e dinjitetit”, të cilat vijnë për shoqërinë shqiptare në kuadër të Edicionit të 19-të të Festivalit Ndërkombëtar të Filmit për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri. Dokumentarët trajtojnë çështje që prekin thellësisht pasojat e politikës së dyerve të mbyllura dhe metodave të errëta të regjimeve autokrate e shoviniste të cilat mbjellin viktima të pafajshme dhe ngadalësojnë procesin e evropianizimit të vendeve të rajonit tonë, përmes metodave të vjetra, të dhunës dhe terrorit. “Të dy temat që trajtohen përmes këtyre dy dokumentarëve, janë relevante, sepse ashtu si në Shqipëri edhe në ish-Jugosllavi shteti, strukturat okulte të lidhura me interesa të caktuara politike, ekonomike, gjeo-strategjike është shumë e vështirë të luftohen, ose të kontrollohen nga vendet demokratike. Shoqëritë demokratike të Evropës Juglindore kanë nevojë për t’u përballur me trashëgiminë e sistemeve diktatoriale dhe policive politike sekrete që ato përdorën për të mbajtur pushtetin. Ajo që ne po bëjmë si institucion është pikërisht nxjerrja në dritë, informimi, ekspozimi i të vërtetave përmes së pari arkivës, dhe përmes studimeve mbi to. Mendoj se të dy filmat kanë vlerën të na tregojë se çdo të thotë të mos përballësh me të shkuarën dhe sa larg shkojnë pasojat.” – tha Kryetarja e AIDSSH-së Gentiana Sula.

Nga ana e tij, presidenti i Festivalit, ekspert ndërkombëtar i të drejtave të njeriut, Prof. Theodore S. Orlin, theksoi se: “E kaluara është parathënie e së ardhmes. Ne nuk mund të kemi një të ardhme pa një të shkuar ndaj Autoriteti i Dosjeve është një institucion shumë i rëndësishëm në përballjen me të shkuarën.”



“Plumbi i Tretë” është një dokumentar politik mbi vrasjen e kryeministrit të parë serb, në 13 mars 2003, Zoran Gjingji, i cili kërkonte evropianizimin dhe daljen e vendit nga hija e errët e luftërave dhe konflikteve etnike të viteve 1990 në ish-Jugosllavi. Vrasja e tij ndaloi procesin e gjetjes së një zgjidhjeje për statusin e Kosovës dhe ktheu forcat nacionaliste dhe proruse në jetën politike serbe.

Po kështu një nga temat shumë shqetësuese ajo e procesit dhimbshëm dhe të vështirë të Identifikimit dhe Rikuperimit të Personave të Zhdukur, u trajtua në filmin “ADN e Dinjitetit”, ku flitet për pasojat e luftës Ballkanike të viteve nëntëdhjetë, e cila rezultoi me zhdukjen e mijëra njerëzve, familjarët e të cilëve vijnë me mbështetjen e institucioneve ndërkombëtare dhe vendase gjësimet për gjetjen e eshtrave të tyre.

Ngjarja u pasurua me diskutime nga Drejtori Ekzekutiv i Festivalit Ndërkombëtar të Filmit për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri, z. Kujtim Çashku, Kryetarja e Autoritetit për Informimin me Dokumente të Ish-Sigurimit të Shtetit, Dr. Gentiana Sula, Drejtorja e Komitetit të Helsinikut, znj. Erida Skënderi, Drejtues i Shoqatës së ish-të përndjekurve politikë z. Ethem Fezollari etj..

## FUNDJAVA BRITANIKE “ZBARKON” NË ARKIVIN E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

Tiranë më 20 shtator 2024



Kineastë dhe gazetarë të njohur britanikë e gjermanë, së bashku me akademiken Lea Ypi, vizituan arkivin e Autoritetit për Informimin me Dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, ndërsa ndodheshin në Tiranë në Javën Kulturore Britanike.

Ekspertë të temave nga historia dhe kultura ballkanike, të drejtat e njeriut, migracionit, çështjeve të sigurisë, nga politika te poezia, gazetarë, teksa vizituan arkivin e AIDSSH-së, kërkuan të njihnin më thellë të kaluarën e Shqipërisë, mekanizmin e errët të shtypjes dhe pasojat e regjimit diktatorial.

Kryetarja e Autoritetit, Dr. Gentiana Sula i njohu me historinë e veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit, dokumentacionin e krijuar dhe përndjekjen e qytetarëve gjatë periudhës 1944-1991. Specialistë të arkivit dhe të mbështetjes shkencore prezantuan tipologji të ndryshme dokumentesh, botimet shkencore, ekspozitat informuese dhe edukuese.

“Vizitorët e huaj duan të mësojnë më shumë për Shqipërinë, një vend me kulturë jashtëzakonisht të pasur, në atë udhëkryq mes Perëndimit e Lindjes, ku idetë shpesh janë përplasur tragjikisht e ku mësimet e historisë ndonjëherë përthithen me vështirësi.” - tha akademikja Lea Ypi gjatë vizitës në arkivin e AIDSSH-së.



## MBAHET KONFERENCA E 16-TË E RRJETIT EVROPIAN I POLICISË SEKRETE

Tiranë, më 4-5 tetor 2024

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) mirëpriti në Tiranë Konferencën e 16-të Vjetore të Rrjetit Evropian të Autoriteteve Përgjegjëse për Dosjet e Policisë Sekrete.

Përfaqësuesit nga Shqipëria, Bullgaria, Republika Çeke, Sllovakia, Gjermania, Hungaria, Polonia dhe Rumania ndanë arrijtjet e tyre në menaxhimin e dokumenteve të ish-policisë sekrete dhe diskutuan për strategjitë e bashkëpunimit brenda rrjetit, përfshirë rolin e dokumenteve në edukimin e brezave të rinj.

Konferenca, e cila për herë të parë organizohet në Shqipëri, zhvillohet me temën “Vizion i përbashkët - veprime sinergjike” dhe përfshin fjalime nga znj. Gentiana Sula, Kryetare e Bordit të Autoritetit, z. Karl Bergner, Ambasadori i Gjermanisë në Shqipëri, si dhe përfaqësues nga Kuvendi i Shqipërisë. Në fokus ishin diskutimet rreth çështjeve që lidhen me procesin e menaxhimit të shqyrtimit të dosjeve të ish-policive sekrete, si një proces i pashmangshëm pas rënies së diktaturave në Evropën Qendrore dhe Lindore, shkëmbimi i eksperiencave, përballimi i sfidave profesionale, si dhe bashkëpunimi për një narrativë të përbashkët evropiane.





Dr. Gentiana Sula, Kryetare e AIDSSH-së tha se institucionet e këtij rrjeti luajnë një rol kyç në luftën kundër ekstremizmit dhe në ndërtimin e një kulture përpalljeje me të shkuarën: “Ky është një moment kritik, kur vlerat evropiane dhe euro-atlantike të demokracisë, lirisë dhe të drejtave të njeriut përballen me sfida të mëdha. Përherë e më shumë bindem që kjo punë që bëjmë ne është shumë e nevojshme për shoqërinë, është shumë e nevojshme të lidhemi me njëri-tjetrin. Do doja që kjo lëvizje të shtohet. Do doja shumë që Kroacia, Maqedonia, Kosova të kishin të njëjtat lëvizje, të njëjta institucione. Vetëm duke punuar së bashku, duke ndërtuar partneritete dhe përkushtuar burimet tona, mund t’i japim drejtësi të vërtetë viktimave dhe të ndërtojmë një të ardhme më të mirë. Përkon kjo mbledhje me përvjetorin e rrëzimit të Murit të Berlinit, një ngjarje historike që i hapi rrugë ndryshimeve për liri dhe të drejta njerëzore në vendet tona. Kjo na kujton se sa e brishtë mund të jetë demokracia dhe se sa shumë kemi për të mësuar nga e kaluara. Në këtë kontekst, dua të mirëpres në mënyrë të veçantë anëtarin më të ri të këtij rrjeti – Ukrainën.”

Znj. Klotilda Bushka, kryetare e Komisionit të Ligjeve dhe të Drejtave të Njeriut, në përshëndetjen e saj, theksoi: “Unë jam e nderuar të jem sot mes jush duke vlerësuar se të gjitha autoritetet e kujtesës janë të rëndësishme, jo vetëm që e vërteta të jetë në dritë njësoj për të gjithë e bazuar në fakte, me qëllim që brezat të njihen me të dhe t’i jepet mundësia komuniteteve të mos përsëriten gabimet e të shkuarës, por, në të njëjtën kohë, për të nderuar viktimat dhe për të qenë pranë familjarëve të viktimave dhe për t’i thënë që nuk harrohen. Nuk harrohen jo vetëm për hir të vuajtjeve të tyre, por dhe për të ndihmuar që në të ardhmen ngjarje të tilla mos të përsëriten.”

“Është e rëndësishme për mbarë shoqërinë që të shërohet dhe të kuptojë të shkuarën dhe mekanizmat e funksionimit të atij sistemi, por dhe të krijojmë kulturën e kujtesës dhe të përballjes me të shkuarën brenda shoqërive tona. Nga përvoja personale mund të them se na u desh shumë kohë për të tejkalluar turpin për të folur hapur për atë pjesë të historisë së Gjermanisë, që është pjesë e vendit tonë. Përballja me ato kohë është themeli i shtetit gjerman. Njerëzit duhet të kuptojnë mekanizmat e atyre sistemeve, sepse shtypjen nuk e krijoi një sistem abstrakt, por njerëzit. Duam të kuptojnë si funksiononte ajo kohë. Duam ta mbajmë gjallë atë kohë. Ajo është vetëm histori për të rinjtë, ndërsa për ne ka qenë formë jetese. Kjo ndikon për të kuptuar rëndësinë e demokracisë që kemi sot,” – u shpreh Ambasadori i Gjermanisë në Shqipëri, Karl Bergner.



Sekretarja e Përgjithshme e AIDSSH-së, Sofi Noti, theksoi rëndësinë e shkëmbimit të përvojave në procesin e hapjes së dokumenteve të Sigurimit të Shtetit, duke ndjekur modele nga Polonia dhe Gjermania, si dhe nga vende, si Bullgaria dhe Hungaria. Në përgjithësi, shkëmbimi i përvojave dhe mbështetje për kujtesën historike janë thelbësore për të gjitha vendet në këtë proces. Më tej ajo u ndaj në procesin e digjitalizimit dhe kontrollin e cilësisë.

Svitlana Starovoit, nga Arkivi Shtetëror i Institutit të Kujtesës Kombëtare të Ukrainës tha: “Lufta është bërë pjesë e përditshmërisë. Arkivi i Ukrainës, i krijuar në 2016, përballet me probleme financiare dhe logjistike. Dokumentet janë të aksesueshme për publikun, por qytetarët kanë nevojë për orientim. Ekspozitat që krahasojnë persekutimet e kaluara me ato aktuale ndihmojnë në ruajtjen e kujtesës historike, duke treguar se historia përsëritet. Ukraina po përballet me rrezikun e totalitarizmit dhe po punon për digjitalizimin e dokumenteve për të lehtësuar aksesin në dokumente”.

Nga Arkivi i Dokumenteve të Stass-it, Alexandra Titze theksoi se puna dhe misioni i Autoritetit Gjerman “është i njëjtë pak a shumë me institucionin tuaj. Sigurisht që kemi arkivuar dhe mbledhur dosje me qëllim njohjen e historisë. Qytetari gjerman ka akses në këto dokumente qoftë për studim apo dhe për të njohur të shkuarën. Këto dosje kanë shërbyer po ashtu dhe si një formë këshillimi për familjarët. Për t’i qëndruar pranë duke ofruar mbështetje psikologjike, punë kërkimore, edukim dhe promovim për këto dosje.”

Ndër të tjera, Boris Mihaylov, Komisioni Bullgar (COMDOS/CDDAABCSSISBNA) tha se: “Bullgaria përballet me probleme të ngjashme me Shqipërinë, duke përfshirë një klasë politike të trashëguar nga ish-komunistët. Ekstremizmi dhe partitë ekstreme janë në rritje, me individë të lidhur me ish-shërbimet sekrete në pozita kyçe. Edhe pse arkivat janë të hapura për publikun, shoqëria e pranon normalitetin e pranisë së ish-bashkëpunëtorëve në politikë. Një ligj i ri kërkon raportimin e agjentëve në raste specifike.”



Jerguš Sivoš, nga Instituti i Kujtesës Kombëtare të Sllovakisë, u shpreh se vendi i tij ka zhvilluar një “arkiv online që lejon përdoruesit të gjejnë informacion mbi ish-Sigurimin dhe elitat politike. Dy biblioteka speciale ofrojnë literaturë mbi ish-sigurimin dhe marksizmin-leninizmin. Dokumentet digjitalizuar janë të aksesueshme për shkarkim dhe ka një sistem për ndjekjen e kërkesave, i cili është i hapur vetëm për punonjësit”.

Nga Arkivat Historikë të Shërbimeve (ABTL) Hungareze, Gergő Bendegúz Cseh, theksoi se “Hungaria ka krijuar një platformë për kërkuesit, me një projekt pilot që pritet të funksionojë vitin e ardhshëm. Ajo do të përfshijë garanci për sigurinë e dokumenteve të ish-Sigurimit dhe do të ofrojë informacion të detajuar”.



“Një libër i ri mbi Operacionin e Deportimeve në Poloni nxjerr në pah paralele me veprimet e ushtrisë ruse në Ukrainë. Rrjeti sugjeron publikimin e një libri të përbashkët me pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve dhe inkurajon ekspozimin e arkivave në konferencat e ardhshme,” – tha Marzena Kruk nga IPN.

Anton Dukagjini, Drejtori i Arkivit në AIDSSH: “Sfidat për mbledhjen e arkivit kanë qenë të shumta, duke përfshirë edhe faktin se janë asgjësuar dokumente gjatë viteve të fundit të regjimit dhe vështirësitë në deklasifikimin e materialeve të klasifikuara. Mirëpo, me ndryshimet ligjore të vitit 2022, u krijuan mundësi më të lehta për tra-





jtimin e këtyre dokumenteve, duke ndihmuar në përshpejtimin e procesit të deklasifikimit. Digjitalizimi i dokumentacionit arkivor është një tjetër sfidë, që po përmirësohet përmes përdorimit të teknologjive moderne. Kjo do të mundësojë që informacioni të jetë më i lehtë për t'u aksesuar dhe analizuar, duke ndihmuar kështu në identifikimin e ngjarjeve dhe fenomeneve të rëndësishme historike.”

Prof. asoc. dr. Gjon Boriçi nga Instituti i Historisë – Akademia e Shkencave të Shqipërisë - foli mbi “Rolin i dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit në rindërtimin e të kaluarës historike totalitare të Shqipërisë”.



Prof. Dr. Aljula Jubani, Drejtoreshë e Institutit për Studime Evropiane në Universitetin e Tiranës analizoi “Procesin e kthimit të dosjeve të policisë sekrete në materiale edukative, një qasje në të cilën AIDSSH-ja po përparon në drejtim të edukimit të brezave të rinj me ngjarje të së kaluarës sonë komuniste përmes organizimit dhe ngritjes së Platformës “Mësojmë nga e kaluaraburime të hapura arsimore 1994-1991”.

Pas hartimit të draftrezolutës përfundimtare e konferencës, pritet miratimi nga rrjeti dhe më pas do të vendosen hapat e ardhshëm të bashkëpunimit ndërkombëtar, si dhe piketat për projektet e ardhshme të rrjetit, duke përfshirë zhvillimin e një

platforme të përbashkët digjitale dhe zbatimin e strategjive të reja për edukimin dhe informimin publik. Punimet e konferencës u mbyllën me një vizitë në arkivin e AIDSSH-së dhe prezantimin e softuerit të arkivës digjitale.

Në përfundim të konferencës, në 5 tetor, në ambientet e AIDSSH-së u përcaktuan hapat e ardhshëm të bashkëpunimit ndërkombëtar drejt një platforme të përbashkët digjitale të anëtarëve të rrjetit.

Rrjeti Evropian i Autoriteteve për Dosjet e Policisë Sekrete është themeluar pas rënies së regjimeve komuniste në vendet e Evropës Lindore për të forcuar bashkëpunimin dhe aksesin në dokumentet arkivore, duke theksuar rëndësinë e transparencës dhe edukimit historik. Rrjeti synon të jetë një forum për shkëmbimin e informacionit dhe të kontribuojë në përbashkëpunimin me të kaluarën në një kontekst paneuropian.



## KRYETARJA E KUVENDIT MBËSHTET AIDSSH-NË NË PËRMIRËSIMIN E LEGJISLACIONIT

Tiranë më 9 tetor 2024



Me Kryetaren e Kuvendit, znj. Elisa Spiropali u diskutua për zhvillimet e Konferencës së 16-të të Rrjetit Evropian të Arkivave të ish-Policive Sekrete, e cila u vlerësua si e dobishme në shkëmbimin e eksperiencave mes 13 shteteve pjesëmarrëse. Konferenca kishte në qendër diskutimin e problematikave që hasin partnerët e rrjetit në menaxhimin e dokumenteve të ish-policiisë sekrete dhe përdorimit të tyre në përballjen me të kaluarën dhe edukimin e brezave të rinj.

Kryetarja e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Sigurimit, znj. Gentiana Sula mori mbështetjen e Kryetares së Kuvendit në funksion të përmirësimit të legjislacionit në: ligjin për trashëgiminë kulturore dhe muzetë, në ligjin për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike, në ligjin për verifikimin e figurave që nderohen me medalje dhe titujt të tjerë nderimi.

U diskutua gjithashtu për ndryshimet ligjore për sa i përket dëmshpërblimit të ish-përndjekurve politikë, ligjit të pensioneve për fëmijët e internuar, e cili është esencial për të vënë në vend një padrejtësi që i është bërë kësaj kategorie.

Znj. Sula shprehu mes të tjerash angazhimin e AIDSSH-së në plotësimin e detyrave të lëna në rezolutën për vitin 2024 votuar nga Kuvendi, përfshirë edhe qartësimin e fatit të të zhdukurve në komunizëm në komunikimin me institucionet e ngarkuara, si dhe krijimit të një baze të të dhënash, për personat e zhdukur, të aksesueshme për publikun.

Çështjet që shqetësojnë Autoritetin në përballje me të shkuarën janë komplekse dhe ndërsektoriale, ato kërkojnë angazhimin e të gjithë komisioneve parlamentare dhe veçanërisht edhe ato të edukimit, sidomos tani që vihet re një fushatë dezinformuese me riciklimin e disa filmimeve të vjetra të së shkuarës totalitare, e cila bie ndesh me punën e AIDSSH-së në edukimin qytetar.

Autoriteti, në punën e tij për edukimin e shoqërisë me ngjarje të së kaluarës, ka pasur vëmendjen e Kryetares së Kuvendit. Në aktivitetin e mbajtur në nderim të viktimave totalitare me datën 23 gusht 2024, në ish-kampin e Porto-Palermos, Kryetarja e Kuvendit deklaroi se: "Kuvendi do të bëjë më të mirën për të plotësuar e përmirësuar legjislacionin për trajtimin, dinjitetin dhe prosperitetin e ish të përndjekurve, njohjen e trashëgimisë së tyre politike, njerëzore e kombëtare, si pjesë e historisë dhe e trashëgimisë kombëtare. Kultura e respektit, paqes dhe pajtimit duhet të edukohet te brezat e rinj, nëpërmjet sistemit arsimor dhe burimeve të tjera edukuese, aspekt të rëndësishëm të misionit të tij si edukator publik, demokratik e qytetar."



## AMBASADORI I OSBE-SË NË TIRANË MBËSHTET PUNËN E AIDSSH

Tiranë më 10 tetor 2024



Ambasadori i ri i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, z. Michel Tarran zhvilloi një vizitë pune në Autoritetin për Informim mbi Dokumentet i ish-Sigurimit të Shtetit, në kuadër të bashkëpunimit disavjeçar dhe mbështetjes së institucionit, si: për ngritjen e programit Master për Drejtësinë Transitore, ekspertizën ligjore në procesin e përgatitjes së udhërfyesit dhe projektvendimit të Këshillit të Ministrave që i hap rrugë procesit të gjetjes së personave të zhdukur gjatë komunizmit, etj.



Kryetarja e Autoritetit, znj. Gentiana Sula, e njohu ambasadorin me punën e bërë gjatë periudhës 7-vjeçare të funksionimit të AIDSSH-së me sfidat që has në drejtim të finalizimit dhe miratimit të vendimit të Këshillit të Ministrave "Për gjetjen, identifikimin, rikuperimin e eshtrave dhe mënyrën e mbrojtjes e ruajtjes së vendvarrimeve të personave të zhdukur gjatë periudhës 29 nëntor 1944 - 2 korrik 1991", nga i cili priten rezultate të prekshme për të gjithë shoqërinë.



Më tej ambasadori u njoh me punën në arkiv, ekspozitat arkivore dhe botimet në kuadër të edukimit qytetar. Po ashtu u theksua edhe roli i rëndësishëm që institucioni ka në krijimin e narratives të së shkuarës dhe përcjelljen e saj tek brezat e rinj. Në këtë drejtim kryetarja e njohu ambasadorin me qasjet e reja në fushën e edukimit si me përgatitjen e platformës digjitale, interaktive dhe planin e komunikimit në rrjetet sociale, i cili mund të jenë mjeti më mirë që i bën këto histori të së kaluarës më të prekshme dhe më të kuptueshme për ta. "Njohja e së shkuarës dhe kuptimi i historisë është një formë edukimi që u jep të rinjve fuqinë të përballen me sfidat e së ardhmes. Roli i institucioneve si Autoriteti i Dosjeve është jetik në këtë proces. Por është thelbësore që ky mesazh të përcillet në forma që ndikojë drejtpërdrejt tek brezi i ri. Në mbështesim punën e Autoritetit në forma të reja dhe kreative që ka zgjedhur për të komunikuar me ta. Gjithashtu do të vijojmë të mbështesim Autoritetin në punën e nisur së bashku në drejtim të nxitjes së finalizimit të procesit ligjor të VKM-së për të zhdukurit në komunizëm," – u shpreh ambasadori Tarran.



## MBAHET PUNËTORIA “QASJA NË DOSJET E ISH-SIGURIMIT TË SHQIPTARIT”

Tiranë më 25 tetor 2024



14 gazetarë të redaksive të kulturës dhe çështjeve të arsimit, të medias elektronike dhe të shkruar, 7 kërkues shkencorë të departamenteve të kërkimit shkencor në universitetet private dhe publike si dhe 11 studentë të komunikimit, gazetarisë, historisë, sociologjisë dhe shkencave politike morën pjesë në Punëtorinë-Qasja në Dosjet e ish-Sigurimit të Shteti. Kjo punëtori u drejtua nga Dagmar Hovestadt, ish-zëdhënëse për Arkivat e Stassit në Gjermani, një eksperte me përvojë të gjatë në komunikimin dhe menaxhimin e dokumenteve të policisë sekrete.

Kryetarja e Autoritetit, Dr. Gentiana Sula, në mesazhin e saj, tha se: “Për çdo shoqëri demokratike, hapja e dokumenteve sekrete është e rëndësishme, për reflektim

përmirësim, transparencë po sidomos hapja e dokumenteve të një diktature të zgjatur si ajo e jona, jep një shans më shumë për të kuptuar kostot e demokracisë, për të nderuar dhimbjet e viktimave dhe familjeve të tyre dhe për të siguruar një shoqëri demokratike, funksionale të tipit evropianoperëndimor. Arkivat që ne administrojmë përbëjnë një pasuri të vyer për të kuptuar 50 vitet e regjimit diktatorial në Shqipëri, periudhë gjatë së cilës të drejtat themelore të njeriut u nëpërkëmbën, familjet u persekutuan dhe fjalës iu mohua liria. Në bashkëpunim me median dhe studiuesit, qëllimi ynë është të sigurojmë një pasqyrim sa më të saktë të realitetit historik, duke i shërbyer së ardhmes dhe brezave të rinj me përgjegjësi të lartë etike. Gazetarët dhe studiuesit janë të mirëpritur të zhyten në këtë material, për të sjellë në dritë fakte të verifikuara dhe të analizuar nga konteksti i kohës së sotme. E vërteta në këtë kontekst është shumë-dimensionaliteti i përvojave të njerëzve dhe ndërthurja e historive personale që na sjellin përpara një tabloje të plotë të asaj që ka ndodhur.” Z. Mauro Puzzo, kreu i departamentit ligjor në OSBE, tha se me këtë rast se: “Transparenca është çelësi për një shoqëri të shëndetshme dhe të informuar. Kur qasja në dokumentet sekrete është e drejtë, e hapur dhe e përgjegjshme, ato bëhen mjete të fuqishme për të kuptuar të kaluarën dhe për të ndërtuar një të ardhme më të drejtë.”



Znj. Dagmar Hovestadt, eksperte e komunikimit, gazetare, me një karriere të gjatë në detyrën si zëdhënëse e Arkivit të Stass, theksoi në fjalën e saj, se roli i medias dhe kërkuesve është jetik në këtë proces, duke sjellë në dritë historitë e harruara dhe duke ndihmuar publikun të reflektojë mbi të shkruarën me një sy kritik, por gjithmonë të bazuar në fakte.

Punëtorja vijoi me tej me paraqitjen e eksperiencës së gazetares së Neës 24, Fatmira Nikolli dhe anëtarit të Autoritetit, Albert Nikolla në pozitën e kërkuesit shkencor gjatë punës me dokumentet. Rasti Camaj dhe keqpërdorimi i dokumentave nga kërkues ishte pjesë e diskutimit të kësaj punëtorie, qëllimi i së cilës ishte kuptimi më i qartë i kontekstit historik dhe ligjor të mbledhjes së këtyre të dhënave dhe transformimi i tyre në një rrëfim gazetaresk të bazuar mbi të vërtetën.

Punëtorja mblodhi të opinionet e medias dhe kërkuesve rreth Manualit për Kërkues dhe Media, i cili do të finalizohet në bashkëpunim me ekspertin e kontraktuar nga OSBE.









AUTORITETI PER INFORMIMIN MBI  
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TE SHTETIT

---

Adresa: Njësia Administrative nr. 4  
Rruga e Dibrës, garnizoni "Skënderbej", Tiranë